

**BARDHYL DEMIRAJ**

**FJALORI I FRANG BARDHIT NË TRASHËGIMINË  
NË DORËSHKRIM TË NIKOLLË KETËS**

**1. Fjalë hyrëse**

Nxitjen për këtë punim e përjetuam gjatë rileximit të një pjese të trashëgimisë postume të eruditit siculo-arbëresh Nikollë Keta (= Niccolò Chetta 1741-1803) që është rrokur si e tillë në librin *Niccolò Chetta. Testi letterari in albanese* (Caltanissetta 2004), i përgatitur si botim kritik prej Matteo Mandalà. Ky botim nuk është sigurisht as i pari dhe as i fundit për filologun pianiot, i cili njihet ndërkohë si njohësi më i kompletuar i trashëgimisë siculo-arbëreshe në kulturën e shkrimit shqip; të asaj në dorëshkrim të Nikollë Ketës po se po.<sup>1</sup>

Le të përqëndrohemi tash në botimin e lartpërmendur, duke saktësuar thukët se përpos materialit gjuhësor arbërisht (f. 1 - 222) ky botim mbart vlera të veçanta edhe për pjesën hyrëse (f. I - CXXVIII) që është një studim i mirëfilltë i botuesit mbi personalitetin dhe prurjet e pazakonshme të Nikollë Ketës në kulturën siculo-arbëreshe përgjatë gjysmës së dytë të shek. XVIII. Prashtu në këtë studim ballor përpos pjesës që paraprin me inventarin e trashëgimisë në dorëshkrim të Nikollë Ketës në arkiva dhe biblioteka të ndryshme deri edhe në pronësi private (f. XI-f. XLVIII), feksin në vazhdim tre krerë, në të cilët autori fokusohet në secilin prej tri teksteve kryesore të këtij botimi (UK, SCM, CM<sup>2</sup>). Në to Mandalà qëmton ndër të tjera edhe do veçori e dukuri jotipike siculo-arbëreshe në fushat e leksikut, të fjalëformimit e të gramatikës, deri edhe në struktura tingullore për një numër njësisish leksikore e frazeologjike,<sup>3</sup> të cilat ai i shpjegon bindshëm si gegizma, pra si ndikime të natyrës diturake, të përfutuara natyrshëm te Keta gjatë leximit dhe konsultimit të veprave të shkrimtarëve të mëhershëm në Arealin Kulturor shqiptar të Veriut. Mandalà përqëndrohet këtu kryesisht në veprën madhore të Bogdanit (*Cuneus*

---

<sup>1</sup> Shih Gurga 2018 17vv.

<sup>2</sup> Mandalà 2004 XLIXvv.: III. L'Urtisia e Krështë (UK); LXVIIvv.: IV. La spiega della creazione di tutto l'Universo (SCM); LXXIvv.: V. Il De creatione mundi (CM).

<sup>3</sup> Mandalà 2004 XCIvv.: VI. Alcune osservazioni linguistiche alle opere in albanese di Nicolò Chetta.

*Prophetarum...*, Patavi 1685),<sup>4</sup> çka i lejon të përsiasë më tej edhe do përpjekje sado rudimentare, por të vetëdijshme të Ketës për koineizimin e shqipes letrare në periudhën në shqyrtim.

### 1.1 Objekti dhe qëllimi kryesor i studimit

Në përputhje me objektin dhe qëllimin tonë të studimit, pra pa u thelluar në çështje që kanë të bëjnë me rindërtimin e komunikimit kulturor-ndërhapësinor në zanafillën e formëzimit të albanologjisë si shkencë rajonale (shek. XVIII),<sup>5</sup> i jemi përkushtuar fillimisht analizës filologjike të një teksti thuajse anësor, i rrokur ky në një rën ndër nënndarjet e rubrikës që përmyll tekstet e transkriptuara të këtij botimi, shi: “III. Testi fol[c]lorici. (2) Proverbi albanesi e siculo-albanesi. (2.a) Modi di dire in lingua albanese” (f. 217-220). Këtu kemi hasur kopjime, përshtatje dhe paralelizma me kreun përkatës në fjalorin latinisht-shqip të Frang Bardhit (= Franciscus Blanchus, Romæ 1635): “Cap. VIII. Prouerbia, & Sententiæ Epirotarum” (f. 207-216; Demiraj 2008 510-531).

Sa i përket vendit ku është arshivuar ky dorëshkrim, nuk mësojmë dot ndonjë kumt informativ në veprën e Mandalà-së, i cili, siç cekëm më lart, paraprin studimin e tij me inventarizimin sot për sot më të plotë të trashëgimisë në dorëshkrim të Nikollë Ketës. Kjo rrethanë na lejon të përsiasim me hamëndje, pra pa vënë dorën në zjarr, që ky dorëshkrim ndoshta gjëllin sot e gjithë ditën i arshivuar në Bibliotekën Mbretërore të Kopenhagës në fondin “Albansk Samling”, përkatësisht në materialin arbërisht të regjistruar në Theca V.82, i emërtuar si: “Proverbi, avverbi, preposizioni etc.” (fol. 45v-67) I gjithë materiali i rrokur në Theca V.82 bart siglën LP (Mandalà 2004 XXII), e cila për një arsye a një tjetër nuk i është nënshtruar një studimi përqasës të mirëfilltë në këtë libër a gjetkë.

### 1.2 Fjalori i Bardhit në rrethin kulturor siculo-arbëresh

Asgjëmangut, përmendim fillimisht që jemi të ndërgjegjshëm që për arsye objektive dhe subjektive nuk jemi në gjendje të rrokim në tërësinë e vet atë qerthull problemor (peri- dhe para)tekstual që lejon të saktësojmë njohjen, përdorimin dhe mundësitë e ndikimit të drejtpërdrejtë ase të tërthortë të këtij fjalori qoftë në gjithë ato shkrime arbërisht që trashëgojmë në dorëshkrim prej Nikollë Ketës ashtu edhe në mbarështimin e kulturës së shkrimit arbërisht në

<sup>4</sup> Ndër autorë të tjerë veriorë që përmend Mandalà në tekst (shën. 3) janë edhe emrat e Pjetër Budit e të Gjon P. Nikollë Kazazit. Për dijeni shtojmë këtu që tekste arbërisht të përziera me tipare gege na dalin më herët te një tjetër autor siculo-arberesh, shi te Zef Schirò (prosenior); sh. Demiraj 2015 85-131; 2016 117-173.

<sup>5</sup> Studiuesi arbëresh Francesco Altimari e pas tij edhe Matteo Mandalà po e emërtojnë këtë fazë të zhvillimit të kulturës arbëreshe gjithnjë e më shpesh si ‘rilindje para Rilindjes’. Kësaj teze, që e kemi prekur kalimthi në tjetër vend (Demiraj 2018 165vv.), shpresojmë t’i përkushtohemi dikur në një punim të veçantë.

aktivitetet intelektuale të Seminarit Italo-Arbëresh (Palermo 1734 ~ Piana degli Albanesi). Gjithsesi gjatë kërkimeve tona kemi mundur të qëmtojmë me përsiatje kauzale ndonjë të dhënë bindëse, që shpresojmë se dëshmon njohjen dhe konsultimin e mëhershëm të këtij fjalori, madje qysh në themelimin e Seminarit Italo-Arbëresh (edhe) si vatër e formimit intelektual albanologjik.

Prashtu, gjatë leximit dhe krehjes së materialeve burimore në dorëshkrim që janë botuar deri sot, sikurse edhe studimeve mbi to, mësojmë që rektori i dikurshëm i seminarit Pal Maria Prifti (= Paolo Maria Parrino), pararendës dhe mësues i Ketës, ta ketë cituar fjalorin në fjalë si i pranishëm atëbotë në bibliotekën e seminarit. Për këtë dëshmi të natyrës bibliografike i jemi mirënjohës Matteo Sciambra-s, i cili i ka kushtuar këtij autoriteti në kulturën arbëreshe të shek. XVIII studimin e thelluar “Paolo Maria Parrino scrittore siculo-albanese”, të shpërndarë në disa fashikuj të revistës ”Shëjzat – le plejadi” (XI [1967] 134-156, 281-301, 393-434).<sup>6</sup>

Një dëshmi pas gjase të mëhershme arrijmë ta rindërtojmë po me rrugë kauzale gjatë leximit të kujdesshëm të botimit (përkthyer italisht) të materialit në dorëshkrim: *L'osservanza del rito presso gli Albanesi d'Italia perché giovino a se stessi e a tutta la Chiesa* (Palermo 2007) me autor themeluesin e vetë seminarit, At Gjergj Guxetën (= Padre Giorgio Guzzetta), i mirënjohur qysh në gjallje të vet si *Apostolo degli albanesi di Sicilia*.<sup>7</sup> Në këtë dorëshkrim At Gjergj Guxeta përcjell në debatin intelektual të kohës rezervat e tij lidhur me shkrimin shqip të autorëve shqiptarë (të Veriut = maqedonasit modernë), sa vijon:

“Si rrjedhim, janë për t’u lëvduar maqedonasit modernë, që, të mësuar mirë në shkronjat latine në Kolegjin e Propaganda Fide-s, morën nismën të shkruajnë në këtë gjuhë libra shumë të devotshëm për t’u përdorur nga populli i tyre dhe për t’i botuar ata në kohën tonë me shkronjat tipografike (të njohura). Në tipin tonë të shkrimit disa përdorin shkronjat latine dhe, duke qenë se gjuha shqipe midis bashkëtingëlloreve shtie në përdorim tingujt e aspiruar grekë, [...] ata preferuan të shpiknin shkronja të reja në vend të atyre greke.

Prandaj duke lexuar këta libra më shqetëson jo pak fakti që ata, duke ndjekur përdorimin e shkrimit galik [= francez - B.D.], i shkruajnë fjalët ndryshe nga mënyra se si i shqiptojnë. [...] Andaj unë, që të mund të shkruaj në këtë gjuhë me më shumë kujdes dhe

<sup>6</sup> Sipas tij (Sciambra 1967 292): “...Parrino fa l’elenco completo di tutte le pubblicazioni uscite fino ai suoi tempi, dalla Stamperia della Congregazione, che val la pena di riportare: Di[c]tionarium Latino-Epiroticum per Rev. D. Franciscum Blanchum...”

<sup>7</sup> Hollësisht së fundi Demiraj 2015 27-75; 2016 39-104. Emrin e këtij kolosi të kulturës shqiptare në kohë e hapësirë nuk e ngjërojmë ende në vepra enciklopedike të rëndësishme kombëtare në Shqipëri e gjetkë, khs.: FESH<sup>1</sup> 1985 dhe ribotimin FESH<sup>2</sup> I-III, Tiranë 2008/9 (red. përgj. Emil Lafa). Hollësisht Demiraj 2017 375vv.

zhdërvjelltësi (sikurse do të veprojnë), do të përdor në të njëjtën mënyrë shkronjat latine dhe, kur këto do të mungojnë, nuk jam aq besëtytë sa të trembem për t'i plotësuar ato me shkronja greke dhe do të përpiqem t'ia përshtat shkrimin shqiptimit korrekt në gjithçka.” (përkth. Gëzim Gurga)<sup>8</sup>

Përkthimi i alfabetit shqip të autorëve të vjetër të Veriut me rezervat përkatëse lidhur me ndjekjen e alfabetit latin, duke i shtuar atij shkronja të veçanta (jogreke) dhe rregulla leximi sipas frëngjishtes tumirin bindshëm përsiatjen tonë se Àt Gjergj Guxeta e njëjtte mirëfilli fjalorin e Frang Bardhit, që vjen me thënë kishte lexuar me kujdes kreun hyrës “Annotationes de lingua, & litteris Epirotarum, seu Albanesiorum” (f. [VI/2v.]) në këtë fjalor, ku Bardhi sqaron, ndër të tjera:

“[...] Por në të shkruar epirotët ose shqiptarët përdorin po ato shkronja si latinët edhe bile mund të themi se të gjitha këto shkronja përkojnë në mes tyre, po mos të kishin shqiptarët, përveç shkronjave latine, edhe tri të tjera të veçanta, krejt në vete. Ja këtu do të jepem (të tria) shkronjat, shembujt e mënyra e shqiptimit: Shkronjat ε, γ dhe ζ. Shembujt: εot “zot”, γyll “yll”, ζee „dhe“.

Mënyra e shqiptimit: shkronja e parë shqiptohet z (= [z]). Shkronja e dytë si u (= [y]) frënge. Shkronja e tretë si th (= [θ]).” (përkth.: Ashta LH III 65)<sup>9</sup>

<sup>8</sup> Citati (në përkthimin) italisht: “Da lodare sono quindi i moderni Macedoni che, ben istruiti nelle lettere latine nel Collegio de Propaganda fide, presero l'iniziativa di scrivere in questo idioma piissimi libri ad uso della loro gente e di consegnarli ai nostri tempi nei caratteri tipografici (noti). Nel nuovo tipo di scrittura alcuni usano i caratteri latini, e poiché la lingua albanese tra le consonanti introduce le aspirate greche, dopo averle abbandonate, sarebbe strano che nel nuovo genere di scrittura di questa gente, trasformassero i caratteri non greci in lettere greche, ma preferirono inventare nuovi caratteri e sostituirli a quelli greci.

Perciò nel leggere questi libri mi irrita non poco il fatto che essi, seguendo l'uso della scrittura gallicana, scrivano le parole in modo [diverso] come le pronunciano. [...] Perciò io, per potere scrivere in questa lingua con maggiore cura e scioltezza (nel modo in cui farò), userò allo stesso modo i caratteri latini e, quando questi mancheranno, [...] e cercherò di conformare la scrittura alla corretta pronuncia in tutto.” (Guzzetta 2007 42v.)

<sup>9</sup> Citati origjinal: “[...]In scribendo tamen ijfdem omnino litterarum caracteribus vtuntur Epirotæ, siuè Albanesij, quibus Latini; Imo ferè in omnibus conueniunt, nifi præter Latinorum litteras, tres præcipuas ac ñingula-res haberent Epirotæ: quorum figuræ, exem-pla modique pronunciandi in præsentì subij-ciuntur: Figuræ ε γ & ζ. Exempla εot, hoc est Dominus. γyl, hoc est Stella. ζee, hoc est Terra.”

Modus pronunciandi: Prima pronuncianda est, vt Z. Secunda om-nino, vt V more Gallorum. Tertia, vt Th. [...]”

### 1.3 Vështirësi të natyrës objektive dhe metodike në studim

Një rrethanë pak a shumë të ngjashme me rastin e Guxetës përjetoi shkruesi i këtyre radhëve edhe gjatë leximit e krehjes të materialit gjuhësor, ndërkohë të botuar ose ende në dorëshkrim që ka për autor Nikollë Ketën. Për lehtësi studimi do të fokusohemi fillimisht vetëm në materialin gjuhësor të nënrubrikës “Modi di dire in lingua albanese” që cituam më lart, anipse edhe për këtë material të tkurrur nuk mungojnë asesi vështirësi objektive e të natyrës metodike. Arsyeja është e thjeshtë: botimi i teksteve në atë libër nuk është shoqëruar me pranëvënien e materialit në dorëshkrim si facsimile. Prashtu, në varësi me këto rrethana jemi të detyruar që në studimin tonë lidhur me marrëdhënien Keta ~ Bardhi të operojmë me dy proporcione përqasjesh tekstuale, ku në njërin syresh mungon një madhësi bazë, si vijon:

? [facsimile – dsh. (Keta)] ~ tekst burimor (Bardhi 1635)  
text i transkriptuar (Mandalà) ~ tekst i transkriptuar (Demiraj)

Asgjëmangut, janë pikërisht këto rrethana që na kushtëzojnë të përqendrohemi fillimisht në studimin tonë kryesisht në përqasjen e varianteve të botuara të materialit dorëshkrimor: Mandalà (2004) ~ Demiraj (2008), çka mundëson nergut shtjellimin e do çështjeve të natyrës filologjike-tekstuale. Duke rrokur në studim si material ndihmës edhe tekstin burimor në fjalorin e Frang Bardhit (1635), lejohe mi të gjenerojmë idealiter edhe mënyrën se si mund të ketë përcjellë, kopjuar dhe përshtatur Keta këto proverba në dorëshkrimin e vet, për të cilin – siç e kemi markuar me pikëpyetje më lart – nuk kemi pasur akses deri sot.

### 1.4 Organizimi i studimit

Në vijim të punimit i përcjellim fillimisht lexuesit në mënyrë tabelare proverbat e regjistruara prej Ketës e të botuara në nënrubrikën e përmendur më lart në botimin e Mandalà-së, duke i parëvënë asaj asaj listën e proverbave që gjëlljnë në tekstin burimor të Frang Bardhit, të ribotuar prej nesh. Sa i përket numërimit, i jemi përmbajtur regjistrimit të tyre në zanafillë, pra në fjalorin e Bardhit, duke iu shmangur kështu vetëm shtesave në fillim si edhe ndonjë ndërkalljeje të rrallë proverbash të tjera në nënrubrikën në fjalë në tekstet e Ketës. Kjo përqasje na lejon të fiksojmë së pari numrin e saktë të proverbave të kopjuara dhe/ose të përshtatura prej fjalorit të Bardhit, gjë që na mundëson të përqendrohemi në vijim në vëzhgime të mirëfillta të natyrës filologjike-tekstuale, ndër to:

- Raste kopjimi (si transkriptim) i tekstit burimor në plotësinë e tij dhe/ose me shmangie e harresa deri në induktimin e vështirësive të mundshme të recepsionit prej autorit.

- Përshtatje të vetëdijshme të tekstit burimor me tipare dialektore anase në fusha të ndryshme, si: leksik, strukturë morfologjike e fjalëformim deri në sosh të natyrës fonetike.

- Përzjerje përvojash si lajthitje të autorit gjatë kopjimit dhe/ose përshtatjes.

- Gabime të dukshme shkrimi të përfutuara në zanafillë gjatë kopjimit/përshtatjes, në mos sosh ortografike gjatë procesit të botimit kritik.

Kjo procedurë metodike lejon të thellojmë më tej hetimin në trashëgiminë arbërisht, ndërkohë të botuar të Nikollë Ketës, duke deduktuar në përfundim do rezultate të përgjithshme lidhur me mënyrën e receptionit dhe shfrytëzimin e fjalorit të Bardhit prej tij. Në këtë mënyrë plotësojmë sadopak vendin dhe rolin e këtij eruditi të pazakonshëm në kulturën siculo-arbëreshe në gjysmën e dytë të shek. XVIII.

## 2. Përfaqje tabelare e materialit gjuhësor

Në tabelën e mëposhtme janë numëruar (kol. I) ato 113 proverba që janë regjistruar në fjalorin e Bardhit (kol. III), ndër të cilat plot 112 rezultojnë të jenë kopjuar, përkatësisht përshtatur në dorëshkrimin e Ketës (kol. II) sipas radhës burimore. Janë rrokur në tabelë edhe raste të rralla proverbash shtesë që janë ndërkallur prej Ketës në dorëshkrim e që e prishin këtë radhë. Këto përjashtime i kemi markuar me shenjuesin <x> (kol. I), pra nuk janë numëruar, meqë edhe nuk ndihmojnë drejtpërsëdrejti në studimin tonë. Për arsye vendi nuk janë rrokur në tabelë proverba të tjera (20 në numër) që prijnë këtë nënrubrikë. Kjo nënrubrikë mbyllet me proverbën e fundit në fjalorin e Bardhit, duke i bërë vend në vijim nënrubrikës simotër “Proverbi usati dai Siciliani”. (Mandalà 2004 221-222)

Le të ndjekim tash nga afër listën e proverbave të dy autorët në bazë të transkriptimeve të realizuara për dorëshkrimin e Ketës prej Mandalà (2004 217-220) e për fjalorin e Bardhit (1635 207-217) prej nesh (2008 510-531):

Nr.	Dorëshkrimi i Nikollë Ketës	Fjalori i Bardhit
1	Veç tënë Zonë prosqinis.	Veçë Tënëzonë adhëroinj.
2	Kush njeft vethenë njeft tënë Zonë.	Kush njeft vetehenë njeft Tënëzonë.
3	Njeri mbledh, e Zot' inë përderdh.	Nier' mbëledh e Zotynë përderdh.
4	Veç Zot' inë isht pa mpkat.	Veçë Zotynë ashtë i pampkat.
5	Ata të mirë, çë të bajsh fgjinjëse, tin Zot ja bën.	Ata të mirë gji të baish fgjinjëse, Tinëzot ia ban.
6	Shogji kã shumë avresie.	Shogji kã shumë arësye.
7	Qish ë gjuquem, s' kã me menguem.	Qish ha gjuquem s kã me mëguem.
8	Qish të bajsh bane urtshim, e shuko si kã daljë.	Qish të baish, bane urtshim e shuko si kã me të dalë.
x	Nani njoh me çë bër bënëen fshiesat	xxxxxxxxx
9	Gjithë kafshënë me të përkuerm.	Gjithë kafshënë me të përkuerm.

10	Njeriu i urt gjith kafshënë tënton.	Nieriu i urtë gjithë kafshënë tendon.
11	Gjindenë shumë duer njerëzish.	Gjindenë shumë duer nierëzish
12	Shukomë stanë, ani të bāmetë.	Shukomë shtanë, ani të bāmetë.
13	Npemjet lisi i mirë njëfet.	N fruitit lisi i mirë njëfetë (i shen Matha 12)
14	E dogj langu bushtërrë.	E dogj langu bushtërrë.
15	Të këqiatë mbësonjënë.	Të këqi[h]atë mbsonjënë.
16	Kush nuk ashtë mbësuaem, s' dī me urdhuruem.	Kush nukë ashtë mbsuem s di me urdhënuem.
17	Mbasi të kēsh zēnë, ani mbëso.	Mbasi të kesh xanë, ani mbo.
18	Majmuni nuk të zihet mbë lak.	Maimuni nukë të zihetë mb lak.
19	Anëmikunë mos qëll zūnë.	Anëmiknë mos e qëll dhūnë.
20	Me mijtë ha e pi, e treg mos ban.	Me mijtë ha e pi e treg mos ban.
x	Me miqt ha e pi, mos kij promati.	xxxxxxxx
21	Njana dorë lān tjetërēnē, e të dia lānjēnē faqenē.	Njana dorë lān tietërēnē e të dýja lānjēnē faqenē.
22	Anëmiku plak s' të bahet cukkē mik, e ndē t' u baft, s' bahet i dērejt.	Anëmiku plak s të bahetē kūrē mik; e ndē t u baftē, s bahetē i dēreit.
23	Sqiferi sē gjitet mbas mizashitë.	Skiferi s gjitetē mbas mizashit.
24	Më mirë me hashturē, se shumë me folë.	Ma mirë me heshtunē, se shumë me folë.
25	Të pā ditunit, e të pā folētē, ashtë të folë.	T pādītunit, të pāfolētē ashtë të folë.
26	Tue folë fjalētē, e fediga rritenē.	Tue folē fialētē e fēdiga ritēnē.
27	Mos jep arešīe të pā ditunit [...]	Mos jep arēsýe t pādītunit, thotē Salomoni.
28	Fjalētē janē grā, të bēmat burra.	Fialētē janē grā, mā të bametē burra.
29	Gjith kush duhet të mbae pajē mjeshtrīsē vet.	Gjithēkush duhetē të mbae pajē mieshtrī sē vet.
x	Kūj pela po i piellnjēnē te lopat	xxxxxxxx
x	Rri fshehurē posi Ariu ndē shtat vēra	xxxxxxxx
30	Nja njeri, çē kā shumë fjalē, nja i shurdhur e munt.	Nja nierī gjī kā shumë fialē, nja i shurdhēnē e mund.
31	Ato kafshē, çē sē të kanē hjē, e sē të pērkasēnē s' duhet me i dasheruem.	Ato kafshē gjī s të kānē hie e s të pērkasēnē, s duhete me i dēshēruem.
32	Ato kafshē, çē bien të dhimptunē, s' duhet me i kuptuem.	Ato kafshē gjī bienē të dhimptunē s duhetē me i kuituem.
33	Ma mirë me dekunē nja herē, se me u rezikuem gjith herē.	Ma mirē me dekunē nja herē, se me u rezikuem gjithēherē.
34	Kish do zogēla, o biblili, ja bie prēndēvēra.	Qish do zogēla o bilbili, ia bie prendevēra.
35	Kūr dro, se të del mā kejq, mos e ban.	Kūr dro se të del ma keiq, mos e ban!
36	Kush ve ndē mullī, do e mos pērmīelletē.	Kush ve ndē mullī, doemos do pērmīelletē.
37	Desherojmē gjith herē ato kafshē, çē sē kemi.	Dēshēroimē gjithēherē ato kafshē gjī s kemi.
38	Gjith kush shukon të mirēn' e vet.	Gjithēkush shukon të mirēnē e vet.
39	Pishku mā parē qelbet ndē kriet.	Peshku mā parē qelbetē ndē kryet.

x	Te kriet qelbet peshku	xxxxxxxxxx
40	Ani i keiq nukë thehet.	Ani i keiq nukë thehetë.
41	Dita e mirë njifet ndënatënë.	Dita e mirë njifetë ndënatënet.
42	Molla nuk rrezohet llarg molletë.	Molla nukë rëxohetë larg mollet.
43	Gjith kafshënë me mot.	Gjithë kafshënë me mot.
44	Duhet me pritunë rent.	Duhetë me pritunë rend.
45	Bushtra çë ngutet me pjellë, ban qellist të verbënë.	Bushtra gjë ngutetë me piellë, ban këlyshhtë e verbënë.
46	Kush çue ka dalë, ve shundosh.	Kush ve këdalë, ve shëndosh.
47	Ki shekull u ongthie ndë asgjëë.	Kÿ shekullë u ngëthye nd asgjã.
48	S' bet besë ndë ketë shekull.	S bet besë ndë këta shekullë.
49	Kush lën këmbiem, këmbiem des.	Kush lën këmbyem, këmbyem des.
50	Ma mirë me pasunë anëmikunë shtruem, se mikunë ...?	Ma mirë me pasunë anëmiknë e shtruem, se miknë e mbuluem.
51	Të sosunit prit.	Të sosunitë prit.
52	Kush djet ndënë dët, e gjãn nëdhë kriet.	Kush dhiet ndë dët, e gjãn ndë krypët.
53	Duhet me strëm kambëtë sã kē të mbuluamit.	Duhetë me shtërëm kambëtë, sã kē të mbuluemitë.
54	Gjith jemi të bijt e mortisë.	Gjithë jemi të bîtë e mortisë.
55	Mornë s' duhet me e haruem, përse sod mue, e nesrë tij.	Mornë s duhetë me e harruem, përse sod mue nesërë tÿ.
56	Si të ndërnjsh, ashtu kē me klënë ....	Si të ndërnjësh, ashtu kē me qenë ndërunë.
57	I belbet mer vesht mëë mirë të belbetit.	I belbëti mer vesht mã mirë të belbëtit.
58	Dëti, zjarmi grueja, tri të keqia të mëdhã.	Dëti, zijarmi, grueja, trÿ të këqia të mëdhã.
59	Kush kã shumë bibër stienë ende ndë lakanatë.	Kush kã shumë bibër, shtie ende ndër lakanat.
60	Një qint të kujtuem, s' pagunjënë një të paguem.	Një gjind të kuituem, s pagunjënë një të pagueme.
61	Grueja e bukurë, e vena e ëmblë, janë helm.	Grueja e bukurë e vena e amblë janë helm.
62	Të vobëgunë ku të e zanë nata, ati ashtë pelasi i tij.	Të vobegunë ku ta zanë nata, aty ashtë pëllasi i tÿ.
63	Ku gjëë s'ashtë, gjëë gjindet.	Ku gjã s ashtë, gjã s gjindetë.
64	Posi leu, ashtu des njeri.	Posi leu, ashtu des nierÿ. (Job.c. 21)
65	Kãli ashtë i atij çë e galkon.	Kãli ashtë i atÿ gjë e galkon.
66	Nja gūr s' ban mūr.	Nja gūr s ban mūr.
67	Dheu i zÿ ban bukën' e bardhë.	Dheu i zÿ ban bukënë e bardhë.
68	S' duhet me sherbiem atij çë së të njef.	S duhetë me shërbyem atÿ gjë s ta njef.
69	Mjaltët shumë herë ban me lepëm gishtat.	Mjaltët shumë herë ban me lepÿm gishtatë.
70	[...]	Kush ban fosënë shogjit, vetë bie ndënë ta.
71	Kush ve mullÿ mã parë, ai mã parë blo.	Kush ve [ndë] mullÿ mã parë, ai ma parë blo.
72	Kush dro zjarrë, n' timit ikën.	Kush dro ziarrë, n timit ikën.

73	Mer pënë ndë do me gjetunë lamshinë.	Merr pënë ndë do me gjetunë lamshinë.
74	Rri strëmënë e flet dërejt.	Ri shtremënë, e flet dërejt.
75	Kūr të shofsh veshet vetii, atë herë qē me pām.	Kūr të shofshë veshët veti, athere kie me e pām.
76	Kush ngau qau.	Kush ngau, kiau.
77	Si më she, ashtu më shkrueti.	Si më she, ashtu më shkrueti.
78	Qet stijënë, e mbëshefën milinë.	Qet shëgjetënë e mbshefën arknë.
79	Ndë nj' anët vesh me hīn, e për tjetërit me del.	Ndë njanët vesh më hīn e për tietërit më del.
80	Ndër të verbënit, ti ende mbërshil sit.	Ndër të verbënit ti ende mbërshil sýtë.
81	I verbëni hjek të verbëninë, e të di ndë humbje [...]	I verbëni hiek të verbëninë e të dy ndë fosët rëxohenë (I shen Math. c.15)
82	Ajo kafshë, çē ashtë mā e bukurë, ajo ashtë mā festfir me e pasurë.	Ajo kafshë gji ashtë ma e bukurë, ajo ashtë mā fëshfir me e pasunë.
83	Lufta pa të dekunë s' ashtë.	Lufta pā të dekunë s ashtë.
84	Të dashunit prej së pāmīt vjen.	Të dashunitë prei së pāmīt vien.
85	Kush kā hū s' këcen.	Kush kā hū, s këcen.
x	Barku plot këmba lot.	xxxxxxxxxx
86	Kush në ças ep, dī herë ep.	Kush nja ças ep, dy herë ep.
87	Kush kā qosmë, amë e atë blë.	Kush ka denarë, amë e atë ble.
88	Gjithë kafsha për aspr.	Gjithë kafsha për denarë.
89	Kālit mirë s' duhenë sporë.	Kāli t mirë s duhenë shpore.
90	Mos me mer, çē mos me qē dhanë.	Mos më merr ç mos më kie dhanë.
91	Lufta e madhe ban pajnë e amblë.	Lufta e madhe ban painë e amblë.
92	E vërteta s' pëlqen gjith kuj.	E vërteta s pëlqen gjithëkūi.
93	Ulku qimënë ndërron ma vesnë s' e harron.	Uku gjimënë ndërron, ma vesnë s e harron.
94	Ende deleshitë së njëfunash ha ulku.	Ende deleshit së njëfunash ha uku.
95	Digjet bāri i njomë ndëpër të thātët.	Digjetë bari i njomë ndëpër të thātët.
96	S' duhet me zënë besë as ujit as Turkut.	S duhetë me zanë besë as ujit, as turkut.
97	Ku Turku ve kambënë, ati s' del bār.	Ku turku ve kambënë, aty s del bār.
98	I këmbiemi gjith herë ban darsëmë.	I këmbiemi gjithëherë ban darsmë.
99	Gjith dhë kā zakonet e vet.	Gjithë dhë kā zakonetë e vet.
100	Hu Zot, e ti Zot, e bār kalit kush i ep?	Hu zot e ti zot, bār kālit kush i ep?
101	Hu fisnik, e ti fisnik, e kasht kālit kush i shtie?	Hu fisnik e ti fisnik e kashtë kālit kush i shtie?
102	Rrefea e shtijme s' këthen.	Shëgjeta e shtīme s këthen.
103	Mos të mundoft i munduemi.	Mos të mundoftë i munduemi.
104	Si të bajsh, ashtu qē me gjetunë.	Si të baish, ashtu kie me gjetunë.
105	S' ashtë mbarrë me mos ditunë; ma me mos dashunë me zanë.	S ashtë mbarre me mos ditunë, ma me mos dashunë me xanë.
106	Vāj aso shtëpie, ku këndon pula e gjeli heshtën.	Vāi aso shtëpie ku këndon pula e gjeli heshtën.
107	Me atë masë çē të matëni me atë kini me	Me atë masë gji të matëni, me atë kini me

	klënë matunë.	kienë matunë.
108	S' ashtë i urt ai që mbërshel derënë oborrit, mbasi i vodhnë kënë o dhitë.	S ashtë i urtë ai gjë mbërshel derënë e oborrit mbasi i vodhnë kënë o dhitë.
109	Mā mirë me djem kriet, se me vū zakon të rī o ligja të rē.	Mā mirë me thym kryetë, se me vum zakon të rī o ligj të rē.
110	Ndë të pasha nja tjetër herë kâ me qënë e dīta herë.	Ndë të pasha nja tietër herë, kâ me kienë e dyta herë.
111	S' duhet me luetunë me gūr përpletë.	S duhetë me lueitunë me gurë përpletë.
112	Mā vëlen nja dhelpenë e gjallë se nja luā i zofët.	Ma vëjen nja dhelpenë e gjallë, se nja luā i cofëtë.
113	Tuk i djeg plakësë ati përket.	Tuk i dieg plakësë aty përket.

### 3. Vëzhgime rreth recepsionit të proverbave në fjalorin e Bardhit

Paraqitja tabelare e listës së proverbave në fjalorin e Bardhit dhe regjistrimi i përpiktë i tyre sipas radhës në botimin e dorëshkrimit të Ketës, duke i prirë si i tillë edhe nënrubrikës me proverba “usati dai Siciliani”, që vjen me thënë përdoren ndër arbëreshët e Sicilisë (= “siculo-albanesi”<sup>10</sup>), të krijojnë një përshtypje të parë se Keta pas gjase ka dashur të ndjekë në zanafillë një strukturë të ngjashme me fjalorin e Bardhit në organizimin e punës së tij leksikografike për realizimin e fjalorit italisht-arbërisht (§ 4).

Gjithsesi pa dashur të humbasim në hamendje të kësaj natyre, vërejmë fillimisht që vetëm në një rast në listën e Bardhit nuk ndeshim gjegjësen përkatëse në botimin e listës së dorëshkrimit, khs.: nr. 70: *Kush ban fosënë shogjit, vetë bie ndënë ta*. Tek-tuk mungon në dorëshkrim edhe pjesa përmbyllëse e proverbës përkatëse, khs.: nr. 50: *Ma mirë me pasunë anëmikunë shtruem, se mikunë... [?] ~ Ma mirë me pasunë anëmikunë shtruem, se miknë e mbuluem.*; nr. 56: *Si të ndërñjsh, ashtu kē me klënë... [?] ~ Si të ndërñjsh, ashtu kē me qenë ndërunë*; nr. 81: *I verbëni hjek të verbëninë, e të di ndë humbje... [?] ~ I verbëni hiek të verbëninë e të dy ndë fosët rëxohenë. (I shen Math. c.15).*

Sa i përket ndërkaljes në dorëshkrim në pesë vende të do proverbave anase, në tri raste mendojmë se Keta ka ndërhyrë vetëdijshtë duke shtënë sosh në tekst thjesht për të sqaruar domethënien në mos gjegjësen e tyre në arbërisht, khs.: nr. 8: *Qish të bajsh bane urtshim, e shuko si kâ daljë.* ~ x. *Nani njoh me që bār bënen fshiesat*; nr. 20: *Me mijtë* [← \*mictə : miqtë] *ha e pi, e treg mos ban.* ~ *Me miqt ha e pi, mos kij promati.*; nr. 39 : *Pishku mā parë qelbet ndë kriet.* ~ x. *Te kriet qelbet peshku*. Ndërsa në një rast ngjerojmë një gjegjëse të përkundërt, khs.: nr. 80: *Kush kâ hū s' këcen.* vs. x. *Barku plot këmba lot.*

Këto vëzhgime paraprake na lejojnë tash të ndërmarim përjasje të mirëfillta të natyrës filologjike-tekstuale (§ 1.4) që lejojnë të shtjellojmë në

<sup>10</sup> Mandalà i bashkon të dyja nënrubrikat nën titullin e përbashkët “Proverbi albanesi e siculo-albanesi” (2004 215)

mos bindshëm, së paku besueshëm recepsionin e tekstit burimor, përkatësisht mënyrën e përcjelljes së tij në letër të bardhë prej Nikollë Ketës dora vetë.<sup>11</sup>

### 3.1 Transkriptime si kopjime pa shmangie ortografike-dialektore

Përfaqja në fjalë dëshmon që Keta në shumësinë e rasteve është mjaftuar me transkriptimin e përpiktë të tekstit burimor, duke e përcjellë atë në njërin ndër kodet alfabetike që ka përdorur në shkrimet e veta arbërisht.<sup>12</sup> Këso rastesh tiparet dialektore të tekstit gegënisht (djathtas) janë më se të dukshme në dorëshkrim (majtas), khs.:

Nr. 9: *Gjithë kafshënë me të përkuerm.* ~ *Gjithë kafshënë me të përkuerm.*

Nr. 11: *Gjindenë shumë duer njerëzish.* ~ *Gjindenë shumë duer nierëzish.*

Nr. 14: *E dogj langu bushtërrë.* ~ *E dogj langu bushtërrë.*

Nr. 20: *Me mijtë ha e pi, e treg mos ban.* ~ *Me mijtë ha e pi, e treg mos ban.*

Nr. 26: *Tue folë fjalëtë, e fediga rritenë.* ~ *Tue folë fjalëtë, e fëdiga ritenë.*

Nr. 36: *Kush ve ndë mulli, do e mos përmielletë.* ~ *Kush ve ndë mulli, doemos përmielletë.*

Nr. 66: *Nja gūr s' ban mūr.* ~ *Nja gūr s ban mūr.*

.....

Transkriptime të kësaj natyre dëshmojnë përpos dukurive fonetike dialektore edhe syresh morfologjike e leksikore tipike gege, që janë rimarrë automatikisht në dorëshkrim prej Ketës khs.:

Nr. 42: *Molla nuk rrezohet llarg molletë.* ~ *Molla nukë rëxohetë llarg molletë.*

Nr. 44.: *Duhet me pritunë rent.* ~ *Duhet me pritunë rend.*

Nr. 48: *S' bet besë ndë ketë shekull.* ~ *S' bet besë ndë ketë shekull.*

Nr. 107: *Me atë masë çë të matëni me atë kini me klënë matunë.* ~ *Me atë masë gji të matëni, me atë kini me kienë matunë.*

Në këtë kategori lejohemi të rrokim gjithashtu shumë proverba që dëshmojnë shmangie sporadike jodialektore të strukturave tingullore-rrokjesore me përdorimin, përkatësisht mospërdorimin vetëm të zanores së pazëshme /ë/, sidomos në pozicion fundor, khs.:

Nr. 10: *Njeriu i urt gjith kafshënë tënton.* ~ *Nieriu i urtë gjith kafshënë tënton.*

Nr. 15: *Të këqiatë mbësonjënë.* ~ *Të këqiatë mbsonjënë.*

Nr. 18: *Majmuni nuk të zihet mbë lak.* ~ *Majmuni nukë të zihetë mb lak.*

Nr. 25: *Të pā ditunit, e të pā folëtë, ashtë të folë.* ~ *T pādītunit, të pāfolëtë ashtë të folë.*

Nr. 38: *Gjith kush shukon të mirën' e vet.* ~ *Gjithëkush shukon të mirënë e vet.*

Nr. 40: *Ani i keiq nukë thehet.* ~ *Ani i keiq nukë thehetë.*

<sup>11</sup> Sqarojmë gjithashtu paraprakisht që ky studim nuk synon aspak nxjerrje të dhënash statistikore.

<sup>12</sup> Mungesa e facsimileve të dorëshkrimit origjinal në botimin e Mandalà-së nuk na lejon të bëjmë deduktimet dhe induktimet e nevojshme të natyrës filologjike. Gjithashtu vëmë në dukje që përfaqset mbështeten në botimet kritike të dy autorëve të ndryshëm: (majtas) Mandalà 2004 ~ (djathtas) Demiraj 2008, përkatësisht në dy praktika të ngjashme por jo të njëjta transkriptimi.

Nr. 67: *Dheu i zī ban bukën' e bardhë. ~ Dheu i zī ban bukënë e bardhë.*

.....

### 3.2 Transkriptime si kopjime me përshtatje ortografike-dialektore

Këtë kategori arrijmë ta izolojmë në proverba zakonisht të shkurtra e me një numër minimal dallimesh dialektore të natyrës kryesisht tingullore, sikurse përvojash të ndryshme ortografike, khs.:

Nr. 3: *Njeri mbledh, e Zot' inë përderdh. ~ Nieri mbledh e Zotynë përderdh.*

Nr. 4: *Veç Zot' inë isht pa mpkat. Veç Zotynë ashtë i pampkat.*

Nr. 23: *Sqiferi së gjitet mbas mizashitë. ~ Skiferi s gjitetë mbas mizashit.*

Nr. 28: *Fjalëtë janë grā, të bëmat burra. ~ Fjalëtë janë grā, mā të bametë burra.*

Nr. 87: *Kush kā qosmë, amë e atë blë ~ Kush ka denarë, amë e atë ble.*

Nr. 88: *Gjithë kafsha për aspr. ~ Gjithë kafsha për denarë.*

Nr. 89: *Kālit mirë s' duhenë sporë. ~ Kāli't mirë s duhenë shpore.*

Nr. 93: *Ulku qimenë ndërron ma vesnë s' e harron. ~ Uku gjimenë ndërron, ma vesnë s e harron.*

Nr. 95: *Digjet bāri i njomë ndëpër të thātët. ~ Digjetë bari i njomë ndëpër të thātët.*

Nr. 102: *Rrefea e shtijme s' këthen. ~ Shëgjeta e shtëme s këthen.*

Nr. 113 *Tuk i djeg plakësë ati përket. ~ Tuk i djeg plakësë aty përket.*

.....

### 3.3 Transkriptime si përzierje përvojash kopjimi

Ndryshe nga kjo kategori (§ 3.2) me inventar proverbash disi të rrudhur në numër, një kategori tjetër rreket të konkurrojë të parën (§ 3.1). Kemi përfshirë këtu proverba që dëshmojnë përzierje përvojash transkriptimi, duke ngjizur së bashku kopjimin pa shmangie dhe atë me përshtatje dialektore. Sigurisht që këtu mëtojnë vendin kryesor rastet, ku feksin dallime, përkatësisht përshtatje fonetike e ortografike, por të shumta janë gjithsesi edhe syresh të kombinuara me sosh morfologjike dhe leksikore, si vijon:

Nr. 1: *Veç tënë Zonë prosqinis ~ Veç Tënëzonë adhëroinj.*

Nr. 2: *Kush njëf vethenë njëf tënë Zonë. ~ Kush njëf vetehenë njëf Tënëzonë.*

Nr. 5: *Ata të mirë, çë të bajsh fgjinjësë, tin Zot ja bën. ~ Ata të mirë gjī të baish fgjinjësë, Tinëzot ia ban.*

Nr. 7: *Qish ë gjukuem, s' kā me menguem. ~ Qish ha gjukuem s kā me mëguem.*

Nr. 12: *Shukomë stanë, ani të bāmetë. ~ Shukomë shtanë, ani të bāmetë.*

Nr. 13: *Npemjet lisi i mirë njëfet. ~ N fruitit lisi i mirë njëfetë.*

Nr. 16: *Kush nuk ashtë mbësuaam, s' dī me urdhuruem. ~ Kush nukë ashtë mbsuem s di me urdhënuem.*

Nr. 41: *Dita e mirë njëfet ndënatënë. ~ Dita e mirë njëfet ndënatënet.*

Nr. 49: *Kush lēn këmbiem, këmbiem des. ~ Kush lēn këmbyem, këmbyem des.*

Nr. 68: *S' duhet me sherbiem atij çë së të njëf. ~ S duhetë me sherbyem atī gjī së ta njëf.*

Nr. 74: *Rri strēmënë e flet dërejt. ~ Rri shtremënë e flet dërejt.*

Nr. 78: *Qet stījënë, e mbëshefën milinë. ~ Qet shëgjetënë e mbshefën arknë.*

.....

### 3.4. Çështje të recepsionit, kopjimit dhe botimit të tekstit burimor

Përjasja midis tekstit burimor (Bardhi 1635 207-217), botimit të tij (Demiraj 2008 510-531) dhe botimit të tekstit të Ketës në dorëshkrim (Mandalà 2004 217-220) nxjerr në pah edhe një numër shmangiesh së paku prej tekstit burimor që mund të përcillen sipas rastit si rimarrje gabimesh shtypi në tekstin burimor, si recepsion i gabuar i tekstit burimor ose i atij në dorëshkrim në mos pakujdesi të përfutuara në dorëshkrim ose gjatë procesit të digjitalizimit të tij. Mungesa e faksimileve të dorëshkrimit nuk lejon assesi përfundime të sakta në këtë drejtim. Andaj po përcjellim këtu një numër rastesh, pa synuar aspak vjelje ballore.

Kështu arrijmë të izolojmë p.sh. si gabim në tekstin burimor të Bardhit që rimerret pas gjase në dorëshkrim e pasqyrohet si i tillë edhe në botim, nr. 19: *Anëmikunë mos qëll zūnë.* (~ *Anëmiknë mos e qëll dhūnë.*), ku njësia e fundit leksikore *zūnë* është rimarrje automatike e gabimit në tekstin burimor <εuune> “dhunë” (f. 208).

Si transkriptime burimisht të pakujdesshme të tekstit burimor, mund të citojmë këtu për ilustrim: nr. 112: *Mā vēlen nja dhelpenë e gjallë se nja luā i zofët.* (~ *Ma vējen nja dhelpenë e gjallë, se nja luā i cofëtë.*) kundrejt gjeqjësës në tekstin burimor: <i zoffete> (f. 217).

Në shumësinë e rasteve të kësaj natyre e kemi gjithsesi të vështirë të izolojmë burimin, ku është përfutur shmangia prej tekstit burimor në fjalorin e Bardhit, khs.:

- Nr. 6: *Shogji kā shumë avresie.* ~ *Shogji kā shumë arësye.*  
 Nr. 8: *...e shuko si kā daljë.* ~ *...e shuko si kā me të dalë.*  
 Nr. 22: *...s' të bahet cukkë mik...* ~ *...s të bahetë kūrrë mik...*  
 Nr. 24: *Më mirë me hashturë...* ~ *Ma mirë me heshtunë...*  
 Nr. 31: *...me i dasheruem* ~ *... me i dëshëruem.*  
 Nr. 32: *...me i kuptuem.* ~ *...me i kuituem.*  
 Nr. 34: *Kish do zogëla...* ~ *Qish do zogëla...*  
 Nr. 45: *...ban qellist...* ~ *...ban këlyshhtë...*  
 Nr. 46: *Kush çue ka dalë...* ~ *Kush ve kādalë...*  
 Nr. 47: *Ki shekull u onghie...* ~ *Ky shekullë u ngëthye...*  
 Nr. 52: *...e gjān nëdhë kriet* ~ *...e gjān ndë krypët.*  
 Nr. 57: *I belbet mer vesht...* ~ *I belbëti mer vesht...*  
 Nr. 75: *...atë herë qē me pām.* ~ *...atëherë kie me e pām.*  
 Nr. 86: *Kush në ças ep...* ~ *Kush nja ças ep...*  
 Nr. 90: *...ç mos me qē dhanë.* ~ *...ç mos më kie dhanë.*  
 Nr. 104: *...ashtu qē me gjetunë.* ~ *...ashtu kie me gjetunë.*  
 Nr. 109: *Mā mirë me djem kriet...* ~ *Mā mirë me thyem kryetë...*

### 4. Fjalori i Bardhit në veprën leksikografike të Ketës

Përjasja e të dy teksteve së bashku me analizën filologjike-tekstuale përkatëse që ndërmorem më lart (§ 3- 3.4) tumir jo vetëm shterueshëm

përsiatjen tonë që Keta e ka njohur dhe shfrytëzuar fjalorin e Frang Bardhit, por na nxit të thellohemi më tej në punën e mirëfilltë të Ketës edhe si gjuhëtar leksikograf. Për këtë nuk mjafton assesi një deduktim i mundshëm prej rrethanës që këto proverba të përbashkëta, të rrokura në nënrubrikën “Modi di dire in lingua albanese” (f. 217-220) përkojnë ndoshta jo rastësisht me njërën ndër rubrikat shtojca të këtij fjalori. Prashtu le të prekim tash sado përcipatas një çështje të fundit që lidhet me pyetjen e natyrshme, se në ç’masë mund të ketë shfrytëzuar Keta fjalorin e Bardhit në punën e tij leksikografike.

Ndonjë dëshmi krejt anësore kemi mundur ta qëmtojmë dikur gjatë leximit të fondit “Gangale” në Bibliotekën e Universitë degli Studi della Calabria (në vitet 2004/5). Gjatë shfletimit disi të përciptë të materialit në dorëshkrim të Nikollë Ketës, të emërtuar: “Lessico italiano-albanese...” (1763) na ra në sy p.sh. regjistrimi disi i pazakontë i toponimit *Skjeri,-a* : <Schiavonia *Schieria*>, që mund ta përcjellim tash natyrshëm si përshtatje e vetëdijshme e Ketës prej geg. ver. *Shkjeni,-a* që e ndeshim të regjistruar si të tillë në fjalorin e Bardhit: <Illyris, Schiavonia *Schienia*> (f. 33); <sciauonia *Schienia*> (f. 144).<sup>13</sup> Bëjmë fjalë këtu për njërin ndër variantet e fjalorit italisht-shqip me rreth 5000 zëra, të cilin Keta e hartoi në moshë fare të re (22 vjeç), pas gjase gjatë përgatitjes së tij për t’u shpërngulur në misionin katolik të ritit lindor në zonën e Himarës.<sup>14</sup>

Botimi kritik i një varianti të dytë, por të plotë i këtij materiali në dorëshkrim prej Giuseppina Cerniglia-s me titull “Leksiko liti kthiellë arbërisht” (Palermo 2008) na lejon tash të ndërmarrim përjasje të mirëfillta me atë material të botuar qëmoti prej Frang Bardhit në fjalorin e tij. Dhe rezultatet janë sa të dukshme aq edhe bindëse, që vjen me thënë se Keta jo vetëm e ka njohur këtë fjalor qysh gjatë periudhës së formimit të tij meshtarak si rishtar i Seminarit Italo-Shqiptar, por e ka shfrytëzuar atë në mënyrë ballore edhe gjatë organizimit të fjalorit të vet, pas gjase për ta shfrytëzuar si mjet ndihmës në komunikimin me besimtarët shqipfolës në zonën e Himarës.

Më poshtë po i përcjellim lexuesit një listë me 100 bashkëpërkime leksikore në materialin shqip mes dy fjalorëve, duke u përpjekur të mos rrokim syresh që shfaqen edhe tek autorë të tjerë (shek. XVII-XVIII) në Arealin Kulturor të Veriut. Asgjëmangut, në këtë studim nuk i kemi vënë vetes qëllim me krehur në mënyrë ballore e me saktësime në çdo detaj të gjithë materialin leksikor në këta dy fjalorë. Pra kemi të bëjmë thjesht dhe vetëm me një listë që sendërton bindshëm përsiatjen tonë që Nikollë Keta gjatë hartimit të fjalorit të tij është mbështetur kryekëput në fjalorin e Frang Bardhit, duke rimarrë, kopjuar e përshtatur prej tij një numër të konsiderueshëm njësisht leksikore, gjë që e ka nxitur më tej të krijojë neologjizma si fjalëformime të reja prej gjedheve të gatshme që përcillte ky fjalor.

<sup>13</sup> Demiraj 2014 178

<sup>14</sup> Hollësisht Cerniglia 2008 14vv. (me burime bibliografike shtesë)

### Vëzhgime redaksionale

Pas numërimit të çdo njësie leksikore-frazeologjike shqip që kemi qëmtuar në fjalorin e Ketës (= markuar në *kursiv*), vjen menjëherë njësia leksikore gjegjëse në fjalorin e Bardhit (= markuar me shkronja të mëdha), të cilën pas dypikëshit e ndjek apo e ndjekin zërat leksikorë (= lemat) përkatës italisht në fjalorin e Ketës. Shenja <+> ndërmjet tyre dëshmon rimarrjen e njësisë leksikore-frazeologjike shqip disa herë në fjalorin e Ketës te këto zëra. Në pak raste njësisish leksikore të përfutuara me prejardhje mungon njësia gjegjëse në fjalorin e Bardhit. Regjistrimi i tyre është bërë thjesht për të vënë në dukje përditësimin e Ketës me gjedhet fjalëformuese të shqipes në dheun amë, përkatësisht shfrytëzimin e tyre gjatë organizimit të fjalorit.

- 1) *bajrak-u* BAI RÁK : bandiera + stendardo; 2) *bajraktar-i* BAI RAKTÁR: alfiere, banderaio; 3) *beleg-u, shtie* ~ BELEG : provocare, sfidare; 4) *biber-i* BIBER : pepe; 5) *bilbil-i* BILBIL : rosignuolo + l'usignolo; 6) *bushtr-a* BUSHTËR : cagna; 7) *çaleshites-i* ÇALLËSHITËS : negoziatore; 8) *çobar-i* ÇOBAN : pastore; 9) *daera* DAENA : tenaglia; 10) *davi-a* DAVĪ : discordia + lite + questione; 11) *davitës-i* DAVĚXHĪ : litigatore; 12) *daviturë* DAVITUNĚ : litigare; 13) *dilber-i* ~ *dillber-i* DYLBĚR : arco celeste (da *djell e bërë*, giacché l'iride si forma da raga del sole, che percuottono la nebbia) + iride; 14) *ellçi-a* ELÇĪ : ambasciaria; 15) *fasando-i* FASANDUE : pavone; 16) *fatos-i* FATOS : fortunato; 17) *frashki-a* FRASHGĪ : ponente + tramontana; 18) *furtere-ja* FURTERE : fressora, padella; 19) *fushnjarë-a* FUSHNJANĚ : fuscina da pescare; 20) *gazment/d-i* GAZMEND : delizia + riso; 21) *gëdhëlëti-a* : adulazione; 22) *gëdhëlëtonj* GĚDHELĚTUEM : adulare, lusingare; 23) *gëdhëlëtues-i* GĚDHELTUES : adulatore; 23/1) *gëdhëlëtueshm-i (i)* : adulatorio; 24) *grārues-i* GRANUES : donnesco; 25) *hajni-i* HAIN : rebelle (e significa traditore); 26) *bënj hajn* : rebellare; 27) *hajni-a* HAINĪ : ribellione; 28) *hajnonj* : ribellarsi; 29) *hambar-i* HAMBĀR: magazzino; 30) *haraç-i* HARAÇ: tributo; 31) *hesap-i* HESĀP : intenzione + opinione + sntenza + rito, cerimonia; 32) *kallabë-a* KALLABĚ : discordia + tumulto, rumore; 33) *bënj kallabë* : tumultuare; 34) *kallabes-i* KALLĀBĚS : tumultuoso; 35) *kalauc-i* KALLAUZ : spia, spione; 36) *kasap-i* KASAP : beccajo + macellaro + macello; 37) *katërdhjetet-i* ~ *katërdhjet-i (i)* KATĚRDHIETĚ (I): quarantesimo; 38) *katërdhjetçim-i (i)* : quadragesimale; 39) *katërdhjetë* KATĚRDHIETĚ : quaranta; 40) *katërdhjetese-ja* : quarantana; 41) *komblik-u* KOMBLIK : catino; 42) *konak-u* KONAK : albergo -ut + hosteria; jec mbë konak : alloggiare, albergare; 43) *konake-ja* : hoste; 44) *kurvar-i* ~ *-tar-i* m. ~ *kurv-a* f. KURVĀR, KŪRVĚ: adultero + bagascia + Fornicario; 45) *vendi i kurvërisë, i kurvavetë* : bordello; 46) *kurvër-i* KURVĚNĪ : adulterio; 47) *kurvëronj* : adulterare, usare con donne altrui + fornicare; 48) *lajm-i (i)* m. ~ *lajme, -ja (e)* f. LAIM (I) : ambasciatore + commissario + corriere, porta lettere + messaggiero; 49) *lajm-itë (të)* : avviso, novella + ambasciaria; 50) *lëng-u* LANG : brodo, guazzetto; 51) *lugat-i* LUGAT: negramente; 52) *mërai* MĚRAI : finocchio;

53) *i mërajmithi* : di color di finocchio; 54) *mif, mifurë* MIFUNË : [z]appare; *mifatar-i* MIFËTËR : [z]appatore; 55) *mireqep-i* MIREQEP : inchiostro; 56) *njegull-a, sic. mjegulla* NIEGULLË : nebbia; *njegullonj, sic. mjegullonj* NIEGULLUEM : abbagliare + anebbiare; *mner-ia* MNËR : timidità; 57) *mneronj* MNËRUEM : temere; 58) *mnerueshim* MNERUESHIM : timidamente; 59) *mnerueshim-i (i)* MNËRUESHIM : timido; temoroso; 60) *ndrikull-a* NDRIKULLË : commare + mam(m)ana; 61) *palare-ja* PALARE : piadena, tondo, sorta di piatto; 62) *pashnik-u* PASHNIK : penda del capo; 63) *pehar-i* PEHËR : coppa, tazza; 64) *pulqier-i* PULQYER : deto grosso; 65) *pushk-a* PUSHKË : archibugio + schioppetta; 66) *qervasar-ia* QERVASARE : taverna; 67) *qerr-i* QERR : carro; 68) *regos-a* RËGÓSË : stoia, stora; 69) *sakizez-a* SAKÍCËZË : manara, scure piccola + secure; 70) *sut-a* SUTË : cerva; 71) *sheitan-i* SHEITAN : satanasso; 72) *sherbell-a* SHERBELË : salvia erba; 73) *shkues-i* SHKUES : messaggero + riferitore; 74) *shukonj* SHUKUEM : mirare + vedere; 75) *shukuem-itë (të)* SHUKUEM (TË) : riguardo; 76) *shtemangët-i (i)* SHTËMANKTË (I) : mancino + sinistro; 77) *shtog-u* SHTOG : sambuco; 78) *trangul-i* TRANGULLË : cetreno; 79) *temalas (i)* TEMALAS (I) : tramontano; 80) *tregetar-i* TREGËTËR : mezzano di negozj; 81) *trageti-a ~ treg-u ~ treg-a* TREGËTË ~ TREG : fiera di mercato + commercio, negozio; 82) *tregetonj* : far il mezzano + trafficare; 83) *me tumirë, vete tumirë* ME VOTË TUMIRË : prosperare; 84) *turmec-i* TURMEC : passero uccello; 85) *udob* UDOB : facilmente; 86) *udob-i [i] ~ udob-a (e)* : facile; 87) *udobë-të (të)* : facilità; 88) *umb-i* UMB ~ HUMB : aratro; 89) *voz-a* : botte; 90) *vozt, -urë* VOZITUNË : navigare + remigare; 91) *vozetar-i* VOZËTËR : remigatore; 92) *gjetetja o dheu çë s'ashtë ndënë urdhënë* GJYTET ... Ò DHË GJI S ASHTË NDËNË URDHËNË : repubblica; 93) *hjek rrumbuik* ME HJËKUNË RUMBUIQ : rimorchiare; 94) *mbarreja* MBARRE : rossore, vergogna; 95) *dheu i të lëmitë* DHEU KU ASHTË LËM NIERI : patria; 96) *të lënë të prinditë* TË LANËTË E ... PRINDET : patrimonio; 97) *guri i paçmuemi* GUR I PËÇMUEM : pietra preziosa; 98) *i pari dheut, zoti madh* I PARI DHEUT, ZOTI MADH : principe; 99) *udhë e pükë* UDHË PÛKË : via pubblica; 100) *xënë* XANË : studiare, imparare etj.

Kësaj liste njësisht leksikore-frazeologjike mund t'i shtojmë edhe do emra të përveçëm dhe toponime, që shfaqen si të tilla së pari në fjalorin e Bardhit, khs.: *Gjergj Kastrioti* GJERGJ KASTRIOTI : Scanderbergo; *Skanderbergu* SKANDERBEG : Scanderbergo; *Skandëria* SKANDËRIA : Alessandria (città); *Sqeri-a* SHKJËNIA : Schiavonia; *Leshi* LESH : Alessio e ndonjë tjetër.

## 5. Përfundim

Mbyllim këtu studimin tonë me shpresën se mundëm t'i përcjellim lexuesit atë qëllim modest që saktësuam në hyrje (§ 1). Pasi arritëm fillimisht të izoloni një tekst burimor me proverba shqip (Bardhi 1635 207-217; ribotuar

prej Demiraj 2008 510-531) në botimin kritik të një dorëshkrimi arbërisht në trashëgiminë postume të Nikollë Ketës (Mandalà 2004 217-220), u thelluar më tej në çështje të recepsionit, kopjimit dhe përshtatjes së tekstit burimor qoftë në dorëshkrimin original ashtu edhe në botimin e tij kritik. Rezultatet e këtij hetimi na joshën më tej të krihnim atë material leksikografik të Nikollë Ketës që ka parë deri sot dritën e botimit (Cerniglia 2008), duke mundur të dëshmojmë shfrytëzimin e thelluar të materialit leksikor të fjalorit Frang Bardhit prej Nikollë Ketës në fazën e parë të aktivitetit të tij intelektual, bash kur përgatitej të shpërngulej në Shqipëri në misionin katolik-lindor të Himarës.

Jemi të ndërgjegjshëm që studimi çalon në njëfarë mase, meqë u rrudh kryesisht në vëzhgime të natyrës krehëse-empirike të atij materiali gjuhësor që disponojmë, që vjen me thënë pa pasur mundësi konsultimi facsimilesh në opusin në dorëshkrim të Nikollë Ketës. Gjithsesi, vëzhgimet e mbështetura në dëshmi material gjuhësor faktik dhe rezultatet e fituara prej sosh shpresojmë se përcjellin së bashku një përvojë të mirë për studime të ngjashme të natyrës filologjike-tekstuale me një a më shumë të panjohura në trashëgiminë e kulturës së hershme të shkrimit shqip.

## BIBLIOGRAFI

- Ashta, K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe* (LH), bl. III. Volaj. Shkodër, 2000.
- Bogdani, P., *Cvneus Prophetarum de Chriso Salvatore Myndi* [...]. Patavii, 1685.
- Cerniglia, G., *Leksiko liti kthiellë arbërisht*. Në radhøjën “Albanica” t. 28 (ed. Matteo Mandalà). Palermo, 2008.
- Chetta, N. (= Keta Nikollë), *Lessico italiano-albanese del sac...* (1763 – dorëshkrim: mikrofilm në bibliotekën e Universitetit të Kalabrisë në: “Fondo Gangale”: Theca III.29).
- Demiraj, B. (ed.), *Dictionarium latino-epiroticum* (Romæ 1635) Per R.D. Franciscum Blanchum. Botime françeskane. Shkodër, 2008.
- Demiraj, B., *Shqiptar dhe shqa. Histori popujsh përmes dy emrave etnikë*. Naimi. Tiranë, 2014.
- Demiraj, B., *Studi Filologjici Arbërescë*. Në radhøjën “Albanistica” (ed. Francesco Altimari) Nr. 5. Comet Editor Press. Marzi (Cosenza) 2015
- Demiraj, B., *Gjak i shprishur*. Naimi. Tiranë 2016.
- Demiraj, B., *Areali Kulturor i Veriut (shek. XVI-XIX)*. Onufri. Tiranë 2017.
- Demiraj, B., *Rishtarë arbëreshë në kolegjin urban*. Në: “Matteo Mandalà dhe Albanologjia sot (në 60-vjetorin e lindjes)” (bot. Fr. Altimari, G. Gurga, Sh. Sinani). Fast print. Tiranë, 2018, f. 165-176.
- FESH<sup>1</sup> = *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*: ASHSH Tiranë, 1985<sup>1</sup>.
- FESH<sup>2</sup> = *Fjalor Enciklopedik Shqiptar* (ribotim) I-III. Tiranë, 2008/9<sup>2</sup>.

- Gurga, G., *Bibliografi e kërkimeve shkencore të Matteo Mandalasë*. Në: “Matteo Mandalà dhe Albanologjia sot (në 60-vjetorin e lindjes)” (bot. Fr. Altimari, G. Gurga, Sh. Sinani), Tiranë, 2018, f. 17-28.
- Guzzetta, G. (= Guxeta, Gjergj – shek. XVIII), *L'osservanza del rito presso gli Albanesi d'Italia perché giovino a se stessi e a tutta la Chiesa*. Në radhojën “Quaderni di Biblos. Storia” t. 18/6. Palermo, 2007.
- Mandalà, M., *Nicolò Chetta. Testi letterari in albanese*. Në radhojën “Albanica” t. 22 (ed. Matteo Mandalà). Caltanissetta, 2004.
- Sciambra, M., *Paolo Maria Parrino scrittore siculo-albanese*. Në: “Shêjzat – le plejadi” XI [1967] 134-156, 281-301, 393-434.

## SUMMARY

### THE DICTIONARIUM LATINO-EPIROTICUM BY FRANCISCUS BLANCHUS IN THE INHERITED MANUSCRIPT BY NICOLÒ CHETTA

The object in this study is the *Dictionarium Latino-Epiroticum* by Franciscus Blanchus (Romæ 1635; ed. Demiraj 2008), with focus on its reception in the early Italian-Arbëresh literacy of the XVIIIth century. After we first managed to isolate a source text with Albanian proverbs (Blanchus 1635 207-217) in the critical edition of the inherited manuscript by Nicolò Chetta (ed. Mandalà 2004 217-220), we went deeper into issues of reception, copying and adaptation of the source text, both in the original manuscript and in its critical edition. The results of this investigation arouse our interest in studying the lexicographic material of Chetta that has meanwhile seen the light of publication. (*Lexico liti kthjellë arbrisht*, ms. 1767; ed. Cerniglia 2008). Through this material we learned about the in-depth utilization of the lexical material of Blanchus dictionary by Chetta, who in the first phase of his intellectual activity was preparing to move to Albania by the Catholic-Eastern mission of Himara. We hope that these results, based on the empirical study of the linguistic material at our disposal, will convey a good experience for similar studies of philological-textual nature in the heritage of the early Albanian Literacy.